




REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK Dep. 02 Nr. flet. _____ Broj. stranica _____ Nr. pages _____	Nr. Prot. _____ Br. Prot. 01-3683/15 Prot. No. _____ Data 28.10.2015 Datum _____ Dat _____



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.10.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2929/15, për zyrtarin e lartë z. Florim Salihaj, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve - Gjakovë ” për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, duke u larguar nga personi i autorizuar në bizneset private.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2929/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Florim Salihaj, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve - Gjakovë ”

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë z. Florim Salihaj, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve -Gjakovë ” gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, është identifikuar se ushtron veprimtari private si person i autorizuar ne dy biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 30.09.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Florim Salihaj, ka ardhur në zyrat e AKK-së ku nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar për situatën në të cilën gjendet.

z. Florim Salihaj është pajtuar me faktet që i janë prezantuar, por është arsyetuar se në kohën kur është autorizuar nga pronari i këtyre bizneseve nuk ka qenë zyrtarë i lartë dhe sipas informatave që ka, këto biznese nuk janë aktive dhe nuk zhvillojnë aktivitete por është arsyetuar se është vendosur si person i autorizuar vetëm për çështje procedurale dhe asnjë herë nuk ka ushtruar këtë funksion në këto biznese, por është zotuar se brenda afatit ligjorë do të kërkojë nga pronari i këtyre bizneseve që ta bëjë ndryshimin e kërkuar nga AKK-ë, dhe do të largohet nga pozita e personit të autorizuar në këto biznese.

Me datën 15.10.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohej se z. Florim Salihaj, nuk figuron me si person i autorizuar në bizneset "Radio Taxi-Toni" me nr. biznesi 70065556 dhe "D.P.H Blue Bar" me nr. biznesi 80382286.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Florim Salihaj, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve -Gjakovë", duke bërë ndryshimet sipas kërkesës së AKK-së, në biznesin ku ka vepruar si person i autorizuar, dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Florim Salihaj, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve -Gjakovë".

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

